



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 153, Datë 21.10.2019

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELECTRAL BATRA HPP” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5 pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 95/2 Prot., datë 18.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

Konstatoi se:

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511 Prot, datë 13.08.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 131, datë 29.08.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/38 Prot, datë 30.08.2019, si dhe me shkresën nr. 515/1 Prot, datë 30.08.2019, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511/3 Prot, datë 16.09.2019 dhe nr. 511/4 Prot, datë 07.10.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë

ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
1. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI